

JUMPIN
JUGENDBERATUNG
WINTERTHUR

WIR

Këshillimorja Jumpin për moshat e reja – një ofertë e Qytetit të Winterthurit për të rejat dhe të rinjtë

Për moshat e reja mes 13 dhe 18 vjeç, që janë në kalim nga mosha shkollore në atë profesionale dhe të të rriturve.

Pse vijnë të rejat dhe të rinjtë tek ne

- Sepse kanë sfida në shkollë apo në kohën e lirë.
- Sepse ju duhet përkrahje në gjetjen e një vendi për mësimin e profesionit.
- Sepse kanë konflikte me bashkëmoshatarët apo me të rriturit.
- Sepse ju duhet përcjellje në rast krizash dhe vështirësish në fazën e tyre aktuale jetësore.

Ne dëshirojmë t'i arrijmë bashkërisht qëllimet

- Të rejat dhe të rinjtë vazhdojnë të qëndrojnë në shkollë dhe të arrijnë kështu përfundimin e rregullt të shkollës.
- Të rejat dhe të rinjtë gjejnë një vend për mësimin e profesionit apo ndonjë zgjidhje të tjetër adekuate.

Oferta jonë

- Përpunimi i përbashkët i hapave të zgjidhjes
- Përkrahje në gjetjen e profesionit dhe në kërkimin e vendit për mësimin e profesionit
- Përkrahje në gjetjen e një zgjidhjeje tjetër adekuate, si për shembull Viti parapërgatitor për profesion
- Ndërmjetësim dhe këshillim në rast të konflikteve
- Përcjellje përmes punës sociale në situata të vështira
- Përkrahje në rast sfidash gjatë përditshmërisë
- 1-2 këshillime në javë gjatë një periudhe tremujore
- Tryezë dreke të mërkurave

Vlerat tona

- Kontakti në besim të plotë me të rejat dhe të rinjtë është baza e bashkëpunimit tonë.
- Ne punojmë me anët e forta të të rejave dhe të rinjve tanë në realizimin e qëllimeve të tyre.
- Ne bashkëpunojmë ngushtë me të gjithë pjesëmarrësit (shkolla, autoritetet, institucionet etj.).
- Ne i trajtojmë informacionet në mënyrë konfidenciale

Lajmërimi

- Të rejat dhe të rinjtë apo prindërit mund të drejtohen direkt tek ne.
- Të rejat dhe të rinjtë mund të delegohen tek ne nga shkolla (personeli mësimor, punonjësit socialë, drejtuesit e shkollave) apo institucionet dhe autoritetet tjera përkatësisht të lajmërohen tek ne Pas kontaktimit caktohet një bisedë e parë e përbashkët e obligueshme. Pastaj të rejat dhe të rinjtë bashkë me Jumpin vendosin se si do të fillojnë bashkëpunimin.
- Oferta jonë është pa pagesë.

Wie du uns erreichst:



052 267 22 99
jumpin@win.ch

Besuche uns an unserem Standort im Zentrum von Winterthur. Gemeinsam suchen wir Lösungen, die zu dir passen.

Jumpin Jugendberatung
Untere Vogelsangstrasse 11
8400 Winterthur